

**AKT-THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE "LABORATORI QENDROR" SH.P.K.**

Ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ne zbatim me ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",ligjit nr 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " te ndryshuar , sot **ne daten 22/01/2021** behet themelimi i shoqerise "**LABORATORI QENDROR**" SH.P.K me seli ne **Elbasan, Lagjja Kongresi Elbasanit, zk.8521, pasuria nr.3/46+2-2** nga ortaket e kesaj Shoqerie

1. **Margarita Gjordeni e pajisur me nr personal G95728146L**
2. **Klajdi Stafa i pajisur me nr personal I20902070E**

**VENDOSIN**

Te krijojne nje Shoqeri Tregtare te emertuar "**LABORATORI QENDROR**" SH.P.K me kushtet e meposhtme:

**NENI I**

Themeluesit ne cilesine e ortakeve krijojne shoqerine tregtare "**LABORATORI QENDROR**" SH.P.K me statusin juridik te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne kuptimin e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",ligjit 129/2014, me mjetet e veta financiare duke paguar kontributin ne para.

**NENI 2**

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi, nga ky Akt-Themelimi dhe statutin e bashkelidhur.

**NENI 3**

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin "**LABORATORI QENDROR**" SH.P.K emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat, letrat, faturat etj. Ajo ka vulen e saj ne te cilen eshte shkruar "**LABORATORI QENDROR**", SH.P.K, **Elbasan, Albania.**

**NENI 4**



Shoqeria e ka seline e saj ne:

**Elbasan, Lagjja Kongresi Elbasanit, zk.8521, pasuria nr.3/46+2-2**

Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

#### **NENI 5**

Afati i veprimtarise se Shoqerise do te jete i pakufizuar, me perjashtim te rastit kur ortakët vendosin prishjen e saj.

#### **NENI 6**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj me objekt :

- **Sherbime laboratorike (Laborator klinik-biokimik, hormonal,..etj)**
- **Konsulta mjekesore, konsulta te mjekesise alternative.**
- **Tregti me pakice bime medicinale**
- **Tregtim i produkteve ushqimore, çajra, erza dhe te bimeve eterovajore, perpunim, paketim i tyre, import-eksport.**
- **Tregtim dhe paketim te vajrave te ndryshme bimore me presim te ftohte.**
- **Tregtim dhe paketim i vajrave bimore me distilim, kremra bimore, shampo me vajra bimore.**
- **Transport per nevojat e aktivitetit**
- **Import-eksport sipas legjislacionit Shqiptar.**
- **Dhe cdo aktiviteti tjetër te nevojshem lidhur me objektin e veprimtarise ne perputhje me legjislacionit Shqiptar.**

#### **NENI 7**

Me vendimin e themeluesit te saj, shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline, formen juridike dhe objektin e veprimtarise, mbas berjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kete akt themelimi.

#### **NENI 8**

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte **100.000** (njqindmije) leke shqiptare. I ndare ne:

1. **Margarita Gjordeni 1 kuote me vlere 50% te kapitalit themeltar**
2. **Klajdi Stafa 1 kuote me vlere 50% te kapitalit themeltar**

#### **NENI 9**



Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitime. Ajo eshte pergjegjese per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te tjere.

#### **NENI 10**

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese, ekonomike, financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkelidhur.

Shoqeria do te drejtohet nga organet drejtuese qe perbehen nga asambleja e ortakeve dhe administratori. Themeluesit me vendim te veçante do te emerojne dhe nje ekspert kontabel. Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhje me ligjin, " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", si dhe do te krijoje fondin rezerve.

Fitimi neto qe do te rezultoje ne fund te cdo viti financiar pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjeve te mbajtura nga vitet e meparshme do ti kaloje ortakeve.

#### **NENI 11**

Percaktimi i struktures organizative te shoqerise, numri i punonjesve dhe emerimet e shkarkimet ne organet e saj behen me vendim te asamblese se ortakeve. Administrator i Shoqerise emerohet **Z.Margarita Gjordeni**, lindur ne Elbasan e banues ne Elbasan, i pajisur me karte identiteti me numer personal **G95728146L**

Maredheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.

#### **NENI 12**

Rregullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij Akt-Themelimi.

### **THEMELUESIT E SHOQERISE TREGTARE**

#### **"LABORATORI QENDROR" SH.P.K.**

**Margarita Gjordeni**



**Klajdi Stafa**

